

L I G J
Nr. 8999, datë 30.1.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8449, DATË 27.1.1999 “KODI DOGANOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8473, DATË 14.4.1999**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 2 shkronja “d”, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Pika 4 e nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, ndryshohet si më poshtë:

“4. Ministri i Financave mund të autorizojë hapjen e “Duty free shops”, (dyqane të çliruara nga taksat) në aeroporte, që ndodhen në zonën doganore të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, për shitjen e produkteve, me përjashtim nga detyrimet e importit.

Formalitetet dhe procedurat që ndiqen në këto raste përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Pas pikës 4 të nenit 199 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Autorizimet e regjimit të magazinës doganore të tipit C, të miratuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, për hapjen e “Duty free shops” (dyqane të çliruara nga taksat), në zonat doganore tokësore, kufitare, dhe në portet detare, me përjashtim të atyre të aeroporteve, revokohen pas 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas kësaj date, mallrave gjendje u jepet njëri nga destinacionet doganore, të parashikuara në dispozitat e këtij kodi, ndërsa të gjitha “Duty free shops”, me përjashtim të atyre në aeroporte, mbyllen.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3689, datë 10.2.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.